

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

SHOQERIA: "SABINA"

**AKTIVITETI: "FRAKSIONIM INERTESH
MALORE"**

VENDODHJA: BERDICE, SHKODER

QERSHOR, 2014

Hartoi raportin Experti mjedisor:

HYSEN DOCI

PERMBAJTJA

1-HYRJE

2-KUADRI LIGJOR

3-TE DHENA TE PERGJITHSHME PER SHOQERINE

4-RELACIONI TEKNIK

5-KARAKTERISITKAT E ZONES KU DO TE KRYHET AKTIVITETI

6-GJENERIMET E NDOTJEVE NE MJEDIS, MASAT PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

7- PLANI I MONITORIMIT

8-PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCAVE

9-REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

10-SHTOJCAT

1 – HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne cdo aspekt te vetin, pervec dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe "produkte" qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proves. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizike dhe human te aktivitetit ‘Fraksionim inertesh malore’, gjate funksionimit te kompleksit. Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Ndikimi efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues Vleresimi —> analiza qe i behet ketij projekti Mjedis —> elementet abiotike dhe biotike

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimit njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

2 - KUADRI LIGJOR

Hartimi i ketij Raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, ka marre parasysh dhe eshte mbeshtetur ne legjislacion mjedisor si me poshte:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligjin nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligjin Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date 04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"
Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

VKM Nr.268, date 24.04.2007 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr. 247, date 30.04.2014 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr. 3, date 02.12.2013 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr. 429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

3 - TE DHENA TE PERGJITHESHME

Shoqëria “Sabina” Sh.p.k, me nr. Nipt K16619001G me administrator Z. Sami Shoshi, e ushtron aktivitetin e saj fshatin Beltoje, Komuna Berdise, Shkoder, ne krahun e majte te rruges Shkoder - Lezhe, ne distance te konsiderueshme nga rruga. Objekti lidhet me rruge fshati dytesore me rrugen nacionale SH-LE.

Projekti konsiston ne larjen dhe fraksionimin e inerteve malore, te marre nga subjekte qe kane si aktivitet te licensuar “Shfrytezimin e inerteve malore”.

Bashkangjitur dosjes se aplikimit gjendet kontrata per blerjen e lendes se pare.

Linja eshte e instaluar, pasi ky subjekt eshte paisur me Leje Mjedisore ne vitin 2007 per fraksionim inertesh lumore. Por ne baze te Vendimit Nr. 2, te vitit 2006 te KKU, i cili ndalon shfrytezimin e fraksionimin e inerteve lumore ne shtrat lumi, subjekti aplikon per leje te re per aktivitetin si me siper.

Kapaciteti vjetor perpunues arrin ne 15 000 m³/vit.


Ky aktivitet ushtrohet ne nje siperfaqe prej 3 000m² dhe eshte ne pronesi te vete pronarit te subjektit.

Siperfaqja identifikohet me Nr. pasurie 669/1. Ben pjese ne zonen kadastrale Nr. 1057, Beltoje, Shkoder.

***Koordinatat e objektit jepen si me poshte:**

Pika	X	Y
1	46 54 470	43 780 700
2	46 55 000	43 78 150
3	46 55 610	43 77 340
4	46 55 800	43 77 750

Objekti ndodhet ne largesine 680 m larg lumit Drin.



Kantieri eshte instaluar ne rrjedhen e vjeter te lumit Drin. Kjo rrjedhe eshte devijuar, kur filloi ndertimi i HEC Ashtes. Shtrati i vjeter, eshte rehabilituar dhe eshte kthyer ne truall normal, ku mund te zhvillohen aktivitetet te ndryshme me karakter njerezor e industrial. Distanca nga shtrati i ri i Drinit, eshte 680 m.



4-RELACIONI TEKNIK

***Pershkrimi i sheshit**

Brenda sheshit jane te vendosura:

Impianti i larjes dhe fraksionimit te inerteve; Mjediset e zyrave e higjenosanitare; Magazina; Paneli elektrik; Vendi i depozitimit te lendes se pare; Sheshi per depozitimin e fraksioneve te ndryshme. Gjithashtu ne kete ambjent bejne pjese edhe hapesirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe siperfaqet e gjelbera, oborri i cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambjenteve, si dhe vendet e magazinimit te materialeve.

***Pershkrimi i procesit teknologjik**

Aktiviteti i fraksionimit te inerteve zhvillohet ne dy linja:

1-Linja e pare.

Materiali inert, depozitohet ne sheshin per kete qellim ose direkt ne bunker. Nga bunkeri me pas ne transportier kalon ne shoshen e imet, per prodhim rere - granil. Ky proces zhvillohet ne pranine e vazhdueshme te ujit me presion. Ketu nepermjet sitave behet seleksionimi i materialit ne granil. Nga ketu rera nepermjet nje ulluku bie ne nje rilarese e cila funksionon me sistem kovash te levizshme dhe nepermjet transportierit transportohet dhe shkon ne shesh si produkt i gatshem per treg.

Materiali i nxjerre perbehet nga:

Rere 0-5 mm; Granil 5-10 mm; Cakull.

2-Linja e dyte.

Lenda e pare nga bunkeri nepermjet transportierit kalon ne mullirin ku realizohet bluarja e gureve te dimensioneve te medha. Ky process realizohet ne prani te ujit. Nga mulliri kalon ne siten dhe nga kjo site, materiali depozitohet me ane te transportiereve ne sheshin qe sherben per magazinimin e produktit te gatshem.

Materiali i seleksionuar eshte:

Granil i imet 5-12 mm; Granil i trashe 15-30 mm; Mbeturine cakulli 20-40 mm
Kapaciteti ditor eshte 65 m^3 lende e pare e perpunuar.

Nga seleksionimi i materialit ne linjen e pare mbetjet ne gure te dimensioneve te medha kalojne ne linjen e dyte ne ate te thyerjes ne mulli. Kjo sherben per te bere sa me eficente dhe per te patur sa me pak mbetje.

Mbetjet e ngurta qe dalin pas mbarimit te procesit rikthehen edhe nje here ne zonen e shfrytezimit te inerteve dhe depozitohen ne brigjet e lumit. Ne kete menyre sherbejne per forcimin e tyre dh embrojtjen nga erozioni.

Uji sigurohet nga nje sistem elektropompash nga nje pus ekzistues i cilie shte fare prane sheshit ku zhvillohet ky aktivitet.

Ky proces zhvillohet ne pranine e ujit per te evituar pluhurat. Gjithashtu ky uje riciklohet per te bere larjen e materialit.

Pas riciklimit ujerat permes nje dambe ku behet dekantimi kalojne perseri ne procesin e punes dhe pjesa tjeter e ujit mund te bashkohet me ujerat e tjere siperfaqesore ose derdhen ne kanalizimet anesore te rruges.

Makinerite qe marrin pjese ne kete process pune jane:

1. Bunker zhavori

2. Transportier

3. Shoshe

4. Ulluk shkarkimi

5. Larese

8. Ulluk i cakullit

9. Ulluk i granilit


10. Paneli elektrik

11. Transportiere

12. Mulliri

13. Pompe uji

***Ne menyre skematike**



5-TE DHENAT PER GJENDJEN SOCIAL-EKONOMIKE DHE FIZIKE TE ZONES

Klima

Meqenese behet fjale per nje aktivitet qe zhvillohet ne territorin e Shkodres atehere po japim disa te dhena te pergjithshme per kete zone per ta patur nje ide me te qarte ne lidhje me zonen ku zhvillohet aktiviteti.

Temperatura

Temperatura mesatare vjetore 15.6°C,

Temperatura mesatare e Janarit 4.2°C

Temperatura mesatare e Korrikut 28°C

Reshjet

Sasia mesatare vjetore e rreshjeve: 1680 mm.

Sasia maksimale vjetore e rreshjeve: 2450 mm.

Diellzimi

Ore me diell ne vit 2500 ore.

Vlefte mesatare e ngrohjes se 50.51 kkal/cm².

Muaji me me shume ore dielli eshte korriku me rreth 350 ore dhe me me pak eshte dhjetori me 100 ore.

Keto vlera te larta krijojne kushte optimale per zhvillimin e bimesise pyjore rreth objektit ne fjale duke krijuar keshtu nje peisazh shume terheqes.

Lageshtia

Lageshtira mesatare vjetore 67%

Lageshtira minimale e Gushtit 52 - 55 %

Lageshtira maksimale ne Nentor 76%

Era

Shpejtesia e eres nga 22-40 m/sek.

Drejtimi i ererave kiyesisht verilindore dhe lindore .

Hidrologjia

Objekti ndodhet ne nje distance mjaft te madhe nga shtrati i lumit Kiri, Buna dhe Drini, e gjithashtu liqenit te Shkodres, kjo pasi ai gjendet ne brendesi te qytetit te Shkodres, prandaj nuk mund te kete ndikimi te anasjellta me shtreterit e lumenjve.

Flora dhe fauna e zones perreth.

Per te pershkruar floren dhe faunen e zones perreth me qene se objekti ndodhet ne brendesi te qytetit te Shkodres mund ti referohemi flores dhe faunes tipike te qytetit.

Flora e zones perfaqesohet kryesisht nga gjelberimi rrugor kryesisht ligustre dhe bli. Gjithashtu ne floren e kesaj zone bejne pjese vegjetacioni i oborreve qe ndodhen prane objektit me bimet e zakonshme dhe karakteristike te ketyre objekteve si druret frutore, bimet e uleta, shkiirret, etj.

Fauna po ashtu eshte ajo tipike e qylelit e cila perbehet nga shpende te tille si harabeli, dallendyshct, laraska, pellumba, etj., pa ndonje vlere te vecante biodiversiteti.

6-NDIKIMET E MUNDESHME NE MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

Procesi i vleresimit te ndikimit ne mjedis, siguron nje permbledhje te informacionit te disponueshem ne perputhje me kushtet e vendodhjes se vepres duke perfshire kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, kulturen dhe kushtet social ekonomike te zones. Ne kete proces vleresimi te ambientit, informacioni per kushtet e vendodhjes se vepres se bashku me standartet dhe normat e aplikueshme jane perdorur per vleresimin e potencialit ambientor dhe te ndikimeve sociale per objektin.

Ndikimet potenciale mjedisore te trajtuara ne procesin e vleresimit te ambientit perfshin:

Ndikimet per ajrin, burimet ujore, burimet tokesore dhe kushtet social ekonomike dhe kulturore gjate ndertimit dhe operimit shoqeruar me infrastrukturen. Vleresimi i kushteve social kulturore perfshin punesimin, perdorimin e tokes, burimet per materialet baze, transportin dhe sherbimet per komunitetin lokal.

***Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objekteve te ndertuara nga njeriu**

Punimet e ndertimit ndikojne edhe ne drejtim te mjedisit human. Ky ndikim eshte shume planesh. Ai mund te jete i drejtperdrejte ose i terthort, sikurse mund te jete negative, ashtu edhe pozitiv.

***Ndikimet ne popullsi**

Duke gene se zona eshte pak sa e vecuar nga zona e populluar ndikimi ne mjedis ka nje influence mjaft te vogel gati e pa konsiderueshme ne krahasim me ndikimin pozitiv qe i sjelle popullsisë se zones e cila me venien ne pune te kompleksit kemi rritje te punesimit te zones.

***Ndikimet e dukshme te projektitne zonat rrethuese dhe pejisazh**

Veprimtaria e projektit perkon me karakteristikat e zones keshtu qe zona sot eshte nje zone ku jane ndertuar objekte industriale e tregtare te cilat ne harmoni me objektit bejne zhvillimin ekonomik te zones.

***Nivelet dhe ndikimet e emetimeve**

Zhvillimi i projektit ka parashikuar masa te repta konform legislatures ne fuqi per ruajtjen dhe administrimin e inerteve. Ndikimet potenciale nga magazinimi dhe dorezimi i lendes inert do te lehtesohen nepermjet perdorimit te praktikave me te mira menaxhuese, te cilat jane praktika qe njesi publike dhe private adoptojne per parandalimin e ndotjes ne operimet e tyre. Nje plan dhe paisje te nevojshme jane siguruar per t'iu pergjigjur clirimit aksidental te inerteve. Subjekti eshte pergjegjes per pergatitjen e ketij plani gjate funksionimit te vepres dhe per te siguruar paisjen e nevojshme per tu pergjigjur ne te tilla raste. Monitorimi dhe kushtet e transportit, sipas te cilave automjetet mund te bejne dergesat, duhet te jene pjese e progedurave te subjektit nepermjet kontrates derguese.

***Nivelet dhe ndikimet e zhurmave**

Zhurmat e emetuara nga operimi do te jene sipas standarteve nderkombetare te 70dB per zonat tregtare/industriale. Ne bazen e furnizimit do te ket levizje te vazhdueshme te automjeteve te cilet do te furnizohen me karburant nga pika e inerteve . Si ne rastin e furnizimit , ate te depozitimit dhe ne rastin e shperndarjes faktori i ndikimit te zhurmave do te jete i pa ndieshem dhe ne asnje rast nuk do ti kaloje 85 dB(A) ne nje minute.

***Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin**

Kemi permendur ne kapitujt e mesiperme se objekti ndertohet ne zonen prane lumit dhe rruget jane te karakterit autoverore dhe te kategoria IV. Ne te dy rastet, subjekti gjat gjithë kohes se shfrytezimit do te pergjigjet per mirembajtjen e tyre si me karikimin me zhavor te rrugeve autoverore te kantierit po ashte edhe ato te kategorise se IV qe lidhin kantierin me rrugen nacionale.

***Ndikimet ne floren, faunen dhe gjeologjine**

Humbja dhe demtimi i habitateve, specieve bimore dhe shtazore.

Ne fazen e ndertimit te impiantit qe kjo eshte realizuar disa vite me pare (theksojme se subjekti ka qene me Leje Mjedisore) se impianti eshte i ndertuar dhe keshtu qe influence te demtimit te abitati nuk ka.

***Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike.**

Ne kete impiant, nuk ka ndodh ky fenomen

Edhe ne aspektin shoqeror-ekonomik, rahabiliti i teritorit, do sjelle impakte pozitive te cilat lidhen me zbutjen e nivelit te varferise se komunitetit dhe levizjes se mjeteve.

***Konsequenca te tjera ekologjike**

Kosekuenca te tjera ekologjike mund te permendim dhe ne mjedisi social ekonomik dhe ndikimet ne mjedisin human . Ndertimi dhe shfrytezimi i impiantit ndikon direkt ne drejtim te mjedisit human. Ky ndikim eshte shumeplanesh. Ai mund te jete i drejt per drejte ose I terthorte. Duke u mbeshtetur ne faktin se ky impjant eshte ne zonen periferike te fshatit dhe jashte planit te fshatit, keshtu qe impakti pozitiv ritet per banoret e fshatit.

***Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones.** Ndertimi i impiantit eshte bere mbi bazen e nje projekti te gjithanshem ne lidhje me kullimin e ujrave siperfaqsove si dhe disiplinimin e tyre nepermjet drenazheve ne gjithe teritorin e objektit.

***Ndryshimet e karakteristikave te tjera hidrografike,** si psh., niveli i ujerave tokesore, i rrugeve ujore, i rrjedhjes se ujerave nentokesore. Gjate ndertimit dhe shfrytezimit nuk kemi ndryshim te karakteristikave hidrografike.

***Ndikimet ne hidrologjine bregdetare dhe te estuareve**

Nuk jemi ne znone bregetare dhe nuk kemi influencia te tilla

***Ndikimet e ndotesve,** mbetjeve, etj., ne cilesine e ujit. Ne projekt jane palinifkuar duke u marre te gjitha masat kunder ndotjes nga hidrokarburet, mbetjeve te ndryshme. Te gjitha keto mbetje jane parashikuar ne projekt ku dhe si do te ruhen qe ndikimi te jete sa me i vogel.

***Ndikimet ne ajer dhe ne klime**

Niveli dhe perqendrimi i emetimeve kimiked**hendikimet e tyre mjedisore**

Impianti i thyerjes dhe fraksionimit nga guri gelqeror, si proces karakterizohet nga nje teknologji e cila parim baze ka perpunimi fizik te materialit duke shnderuar gurin gelqeror ne materiale te fraksioneve te ndryshme, ky proces eshte mekanik dhe nuk ka te beje me perpunime kimike, ndikim kimik ne kete rast nuk ka.

***Lendet e vecanta.** Ne kete process, nuk ka lende vecanta, si rrjedhoje nuk ka :

***Aromat sulmuese.** Procesi mekanik nuk ka te beje me aroma sulmuese

***Ndikime te tjera klimatike.** Ndikime klimatike ndikojne ne fuqine puntore te cilet ndikohen nga puna ne temperatuara te larta por gjithsesi personeli ne gdo rast duhet te jete i mbrojtur nga influencia klimatike e kohes.

***Ndikimet nga trafiku** rruga, hekurudha, ajri, uji) qe lidhen me projektin. Keto ndikime jane te pandjeshme, pozcioni i vensosjes se impiantit eshte ne nje zone jashte qendrave te banuara dhe ku trafiku rrugor i perket nje zone te lokalizuar keshtu qe ne kete rast ndikimet per trasport jane shume te vogla gati te pa konsiderueshme

***Ndikimet e lindura** nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve, ujit, energjise ose burimeve te tjera, si pasoje e projektit. Si rezultat i grumbullimit te lendes ne depozita jane marre nje sere masash drastike te mbrojtjes nga zjari, regullave te sigurimit teknik gjate shfrytezimit, qe te gjitha jane parashkuar ne porcesin teknologjik te funksionimit ketij impianti . Kjo ka bere qe ndikimet jane shume te vogla dhe per gdo ndryshim te parametrave konstatohet nga monitorimi ivazhdueshem qe i behet procesit.

***Ndikimet e projekteve te tjera** qe shoqerojne projektin e dhene, si psh., rruget e reja, kanalet e ujerave te zeza, banesat, linjat e energjise, nafte dhe gaz- sjellesve, telekomunikacionet, etj. Rruget e reja kanalizimet linjat elektrike behen qyshe ne fazen e ndertimit dhe mbasi zbatohen normativat teknike te adinistrimit te ketyre proceseve, ndikimet nuke japin sens negativ. Gjate zhvillimit te procesit ne impiant punonjne manovratoret te cilet ndjekin hap pas hapi te gjitha dukurite qe rjedhin nga procesi .

***Ndikimet shoqeruesete** projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara. Projekti implementohet qe ne fazen fillestare dhe nuke nderfutet me projekte te tjera ekzistuese apo te propozuara. Ne gdo rast qe do te lind nevoje parashikohen qe ne projekt uljen e ketyre ndikimeve.

***Ndikimet sekondare** qe rezultojne nga nderveprimi i ndikimeve te tjera direkte, te listuara me siper. Cdo ndikim tjetër sekondar eshte i monitorueshme dhe per gdo kostatim personeli mer masat apo kerkon projekte te veganta ku parashikohet dhe parandalimi i ndikimeve sekondare.

7-MASAT E PROPOZUARA PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

Te identifikohen masat per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis duke dhene disa alternativa per veprimtarine qe ushtrohet. Atje ku jane identifikuar ndikime negative te dukshme, te pershkruhen masat qe do te merren per te menjanuar, zvogeluar ose ndrequr keto ndikime.

Planifikimi i zones; nga analiza e mesiperme verejme se gjate veprimtarise se ndertimit te objektit dhe venies se tij ne shfrytezim ekzistojne disa faktore te cilet kane mundesi potenciale te ndikojne negativisht ne mjedisin e zones dhe me gjere. Ne qofte se gjate veprimtarise se shfrytezimit i kushtojme kujdesin e duhur ketyre faktoreve, per t'i patur vazhdimisht nen kontroll, ky ndikim eshte e mundur te minimizohet ne maksimum.

Por duhet theksuar se ky objekt eshte i hershem dhe ne te jane bere vetem ndryshime ne ristrukturimi dhe te perfeksionimit te linjave, keshtu qe ndikimet jane shume here me te pakta se ne rastet e ndertimit nga faza themelore

Masat teknike, psh.: procesi selektiv; riciklimi; trajtimi dhe kontrolli i ndotjes. Si gjate ndertimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit, eshte parashiukuar ndjekia me kujdes e programit te menaxhimit mjedisor, i cili merr ne konsiderate dhe analizon te gjitha llojet e ndikieve dhe masat e nevojshme per eleminimin e tyre. Ne qofte se gjate veprimtarise se shfrytezimit, i kushtojme kujdesin e duhur ketyre faktoreve, per t'i patur vazhdimisht nen kontroll, ky ndikim eshte e mundur te minimizohet ne maksimum.

Masat estetike dhe ekologjike, si psh. modeli, ngjyra, etj.; pejisazhimi; mbjellja me peme; masat per ruajtur habitatet ose per te krijuar habitate alternative; regjistrimi i zonave arkeologjike; masat per te ruajtur zona ose ndertime historike, rehabilitimi i elementeve te peisazhit

Programi i pergjitheshem i menaxhimit mjedisor dhe plani per zbutjen e ndikimeve, parashikon realizimin e sheshimeve dhe te mbushjes se gropave te krijuara gjate levizjes se mjeteve ne impiant .

Me rehabilitimin e zones nenkuptojme kthimin e plote te mjedisit ne gjendjen e meparshme, dhe krijimin e kushteve per eliminimin ose minimizimin e pasojave negative ne mjedis te krijuara nga shfrytezimi i materialeve. Per kete qellim, krahas shfrytezimit te impiantit duhet bere studimi mbi mbulimin me gjelberim te siperfaqeve te lira duke shfrytezuar ne radhe te pare materjalin e dekantuar nga ujrat lares te inertit si dhe mbjellja e nje bimesie qe duhet te percaktohet ne projektin e gjelberimit nepermejt bashkepunimit me specialist te fushes .

Perve?kesaj, kuptohet qe shtresa e dheut me bimesine qe do te mbillet do te minimizojte pikerisht ato efekte negative, qe permendem me lart lidhur me erozionin e tokes/shkembit.

(Revegjetacioni) Mbjellja e siperfaqes se cenuar Ne te gjitha rastet kur verehet: prerje te drureve, hedhje te dheut ne anet e rruges dhe geryrje te mundshme, investitorir detyrohet qe te realizojte mbjellje te bimeve dhe ne rastin e dherave te kryeje sheshimet e duhura dhe mbjelljen e tyre me bimesi lokale. Kjo gje do te ndihmoi ndjeshem ne eleminimin e demtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese. VIM vendos kushtin fillestar mbi vendin dhe vlereson ndikimet e mundeshme pozitive dhe negative te projektit qe jane identifikuar duke parashikuar mundesine me te madhe te

ndodhjes se tyre. Jane percaktuar masat lehtesuese qe duhen marre gjate funksionimit si dhe eshte identifikuar edhe ndonje ndikim i mbetur negativ.

8-PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCAVE

• Per funksionimin normal te impiantit nje rendesi e vecante i eshte kushtuar vendosja se rregullores per punonjesit e cila afishohet ne nje vend te dukshem e shoqeruar me sqarime per sinjalistiken perkatese te mbrojtjes nga zjarri.

Ky projekt nuk do te ndikoj ne mjedis ne rast te ndonje falimentimi te mundshem, per arsye se eshte nje aktivitet jo ndotes per mjedisin dhe nuk prodhohen lende te rrezikshme te cilat duhen menaxhuar me nje plane te vecante.

Habitati dhe biodiversiteti:

Humbja e tokes, te siperfaqeve me vegjetacion per shkak te implementimit te ketij projekti eshte i paevitueshem por impakt i ketij projekt eshte i vogel. Kjo vjen si rezultat se kjo zone nuk eshte e pasur me bimesi si dhe madhesia e ketij projekti eshte relativisht e vogel. Humbja e habitateteve me vlere nuk konsiderohet si nje problem, i cili nuk eshte hasur gjate fazes se operimit me qe toka perreth nuk eshte e gjelberuar dhe as e mbjelle me peme apo e shfrytezuar si toke bujqesore. Kampi i punimeve dhe rrethina jane instaluar ne nje shesh te zhveshur nga bimesia. Kontrata do te parashtroje te gjitha fazat qe do te ndiqen qe te shmangi cdo ndikim tek habitatet, gjithashtu duhet te programohet qe te siguroje mos shqetesimin e zogjve shtegtare te kesaj zone edhe pse jane ne nivele te paperfillshme. Per zogjte shtegtare ne zonen nuk krijon asnje problem apo shqetesim pasi prona nuk eshte e pasur me bimesi dhe mjedisi uhor eshte lumi .

Cilesia e ajrit: Nivelet e trafikut nga ky projekt do te jene te uleta si i tille ato shkaktojne shkarkimet teper te pakta duke marre ne konsiderate gjithashtu permiresimin e shkarkimeve per automjet e reja si edhe per automjetet e vjetra qe jane zevendesuar. Nje procedure per modelimin e tyre, eshte pershtatur ne menyre qe te behet parashikimi per nivelet e shkarkimeve si dioksid azot (NO₂) dhe pluhur LGS si dhe i resperueshem (PM₁₀) qe prodhohen nga punimet. Megjithate, me qellim qe te verifikohet cilesia e ajrit ne zonen e studiuar, jane ndermarre prova here pas here dhe pas disa muajsh teshte perdorer testimi pasiv si pjese e kontrollit ambjental.

Gjate ketyre fazave, zbatohet sistemi I ngjeshjes se pluhurit, si?eshte lagia me uje e sheshit te kantierit dhe e rrugicave hyrese dhe dalese nga kantieri, te cilat do te ndermerren nga investitori, do te limitojte deri diku shkarkimet e pluhurit ne ajer.

Pervec kesaj, makinerite e levizshme te impiantit, permbushin te gjitha standartet e emetimit ne ajer qe udhezojne direktivat e BE-se dhe legjislacioni shqipetar per normat e shkarkimeve ne ajer.

Zhurmat: Masat e me poshtme jane teper te rendesishme qe duhen aplikuar nga investitori gjate shfrytezimit:

Asnje impiant ne kantier i shfrytezuar per pune te caktuara nuk do te lejohet qe te shkaktoje zhurma mbi nivelin e lejuar ne mjedise perreth zones

Me e mira e mundshme nga ana praktike, behet duke perfshire nje impiant te pershtatshem per mirembajtje, i cili do shfrytezohet per te minimizuar zhurmen qe vjen nga nderhyrjet ne terren.

Te gjitha automjetet dhe makinerite mekanike do te pershtaten mire me te gjithe silenciatoret e mundshem dhe te mirembajtjur ne gjendje te mire pune gjate gjithë zgjatjes se punimeve.

Makineria qe do te perdoren do te mbyllet here pas here ne kohen kur nuk do te nevojitet per shfrytezim.

Cdo lloj impianti, sic jane elektromotoret qe jane te nevojshme per nderhyrje dhe pas oreve te ligjshme te punes, do te mbeshtillen me nje pjese akustike apo ekran te levizshem per te minimizuar ndotjen akustike te mjedisit perreth.

Komuniteti lokal dhe aspektet social-ekonomike: Gjate punimeve do te merren masa te vecanta nga ana e investitorit, me qellim qe te behet mirembajtja e ujit, elektricitetit apo te ndonje rrjeti tjere ekzistues, ku te gjitha punimet do te kryhen pasi te jene informuar institucionet pergjegjese ne numrat e tyre te telefonil. Prona eshte marre ne perdorim tek pronaret e ligjshem dhe eshte prone private dhe e rregjistruar konform ligjeve ne fuqi per pasurite e paluajtshme. Ne kete prone nuk ka objekte banimi.

Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune:

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjelle rrezikshmeri per aksidente, duke qene se nuk do te kete magazinim ose perdorim te substancave te rrezikshme. Ne rast se do te kemi derdhje te lendeve hidrokarbure nga automjetet e transportit, do te merren masa per largimin nga mjedisi si dhe do te vendosen tabela sinjalizuese per te shmangur aksidente rrugore gjate hyrjes dhe gjate daljes ne kantier. Ne kete sheshe jane objekte te ndertuar me planimetri te rregullt duke respektuar kriteret teknike per funksionimin normal te tij. Ai ka siperfaqe te mjaftueshme per kryerjen e proceseve te levizjes se mjeteve, shkarkimeve te materialeve, magazinimit ne sheshet perkatese dhe hapesira te medha per kryerjen e aktiviteteve te tjera , dhomat higjeno-sanitare, dhomat e zhveshjes, etj.

Rrjeti elektrik i zones eshte i ri, gjate zbatimit te projektit per kete rrjet eshte pasur parasysh qe te realizohet tokezimet e nevojshme per te gjitha makinerit, dhe pajisjet e nevojshme.

Punonjesit do te sensibilizohen dhe do te detyrohen te respektojne me perpikemeri te gjitha rregullat per sigurimin teknik.

Detyrimet e punedhenesit: Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.

Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne kantier.

Shkaqet e aksidenteve dhe masat per menjanimin e tyre.

Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.

Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.

Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne kantierin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, ryma elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.

Ndihmen e pare shendetesore.

Tu krijoj punonjesve kushte te mira pune dhe jetese, si:

mjete mbrojtese, ushqim falas dhe fjetje kur punimet kryhen larg vendbanimit te punonjesve.

Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.

Frontet e punes ne zbatimin e objektit, neqese punohet naten, duhet te ndri5ohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ne menyre te pa varur nga ndri5imi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndri5imi ndalohet puna.

Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, kur ate jane duke punuar.

Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje.

Cdo turn para se te fillohet puna, behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive etj.

Gjithashtu duhet tu njohe rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit si dhe trajnimi i punonjesve te ketij objekti, duke krijuar situata te stimuluara.

Detyrimet e punemarresit: **Detyrimet kryesore jane:**

Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i sigurimit teknik dhe inspektorati i punes dhe ti zbatoje ate ne pune. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve ne zbatimin e projektit, per 5do proces pune.

Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.

Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithë punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik.

Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si:

kapele, rrobat me cizme pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecante si dhe veshje kundra zjarrit, etj.

Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCES

Ne veprimtarine e aktivitetit te subjektit, do te zbatohet plani i emergjencave dhe rregullat e sigurimit teknik si me poshte: Te zbatohen rregullat me perpikmeri:

Amballazhet, te hidhen ne vende te caktuara.

Te afishohen rregullat e sigurimit teknik dhe masat ndaj zjarrit ne nje vend te dukshem ku te jene ne cdo rast ne qender te vemendjes.

Te vazhdoji trajnimi i perdorueseve te tjere ku shperndahen lendet e importuara .

Ky objekt ne kushte pune normale nuk prodhon dhe nuk emeton lende te demeshme per njerezit dhe mjedisin.

Te gjitha produktet qe importohen dhe qe jane te depozituara ne objekt jane ne perputhje me VKM dhe jane miqesore ndaj mjedisit.

Me zbatimin e rregullave dhe me pune normale nuk krijohen ndikime mbetese, qe mund te shfaqin efektet e tyre negative ne mjedis me kalimin e kohes ose demtime te shendetit te banoreve, familjareve ose edhe perdorueseve ose tregetareve.

Eshte fakt qe nuk ka patur asnje ankese nga banoret perreth ose diskutim ne ambiente mjedisore qe mund te shfaqin efektet e tyre negative ne mjedis me kalimin e kohes.

SIGURIMI TEKNIK, MBROJTJA NE PUNE.

Ne fazen e zhvillimit te aktivitetit jane te detyrueshme zbatimi i rregulloreve te sigurimit teknik ne pune. Punedhenes i ka detyre.

Te kualifikoje punonjesit per llojin e produktit, karakteristikat e tij, te njohë rregullat e transportit, makazinit dhe shperndarjes.

Te pranoje ne pune persona te afte nga ana shendetesore dhe mendore qe e verteton me raport mjeksor.

Te instruktoi punonjesit per cdo proces pune qe do te kryej

Ti njohe ata me rregullat e sigurimit teknik

Te bei te ditur shkaqet e aksidenteve dhe masat qe duhet te merren per ti menjanuar ato

Te kualifikoi punonjesit per ndihmen e shpejte ne rast aksidentesh.

Pergjegjesi I repartit ose brigadjeri pergjigjet: -Per mungesat e punonjesve ne vendet e punes

-Kur nuk zbatohen rregullat e sigurimit teknik nga punonjesit qe varen prej tij

-Kur ndodhin aksidente apo avari nga mos kerkesa e tij

-Nuk lejon punonjesit te fillojne pune pa u bindur ne aftesite e tyre profesionale

-Kur shikon qe punonjesi nuk eshte ne gjendje te mire shendetsore ose eshte I dehur

-Pergjigjet kur ka urdheruar punonjesit te punojne jashte rregullave te sigurimit teknik

Iventari i nevojshem i M.M.K.Zjarr 1-Fikse me rere fosile(2-5) cope

Fikse me bioksid carboni CO₂-I-OL

Fikseme shkume kimike 20 litra

Sistem uji per shuarjen e zjarrit-pika sherbimi

Kende zjarrfikse me mjete te thjeshta si : fuqi me rere,lopate, sopate ,leva,

9-PLANET E MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT

***Plani i monitorimit te ndidkimit ne mjedis** . Subjekti do te kryeje monitorimin e treguesve mjedisore qe lidhen me impaktet nga veprimtaria, ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 8934 dt. 05.09.2002 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.103 dt.31.03.2002, "Per Monitorimin ne Republiken e Shqiperise". Ne terma konkrete subjekti do te raportoje cdo tre muaj prane DRM Shkoder, mbi rezultatet e monitorimit qe do te konsistojne ne:

- matjen e niveli te zhurmave

evidentimin e ndotjeve eventuale nga perdorimi i karburanteve dhe vajrave.

masat per sistemimin e materialeve te ngurta dhe vegjetacionin gjate sistemimit te mases se materjalit qe del nga procesi i larjes dhe dekantimit

Monitorimi do te vazhdoje per gjate gjithë kohes se shfrytezimit te pikes se furnizimit, deri ne perfundimin e masave rehabilituese qe do te parashikojë projektin.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar pasojat nga ndikimet ne mjedis, zhvilluar sipas nje faze fillestare e cila do te perballtet me problemet e paparashikuara qe jane verejtur ne fazen e hershme.

Kjo lejon nje matje te sakte per te shmangur demet qe mund te shkaktohen me vone. Programet e monitorimit per cdo pjese te komponenteve te mjedisit jane identifikuar dhe ndare sipas pjeseve te meposhtme.

Ne zbatim te kerkesave ligjore per mjedisin, shoqeria, ka bere ne menyre te vazhdueshme monitorim nepermjet matjeve te kryera ne pikat e procesit teknologjik ne mjediset e punes te linjes se perpunim - fraksionimit te inerteve nga guri gelqeror .

Keto matje jane kryer per ndotesit baze (te grupit 0) sig percaktohet ne aneksin nr. I te V.K.M nr. 435, date 12.09.2002 " Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise "

I- Informacion mbi matjet

Matjet jane kryer per linjen e bluarjes dhe fraksionimit te inerteve nga guri gelqeror, vendi i matjes per shkarkimin e ndotesve ne ajer eshte :

a- Ne sheshin e manipulimit te lendes pare e produktit te linjes se bluarjes e fraksionimit, afer sheshit per shfrytezim.

b- Ne linjen e bluarjes te fraksionit + 20 mm ne mullirin me gekiger percaktimin e permbajtjes se pluhurit ne gaze eshte perdorur pompe speciale vakumi me aksesoret perkates si filtra etj. Per percaktimin e permbajtjes se elementeve ndotes SO₂, CO, O₂ jane perdorur aparati " Drager" me ampula specifike per gdo element ndotes si dhe aparati "Trolex" me metoden me sensore.

Matjet jane kryer ne menyre te vazhdueshme, ne pikat e shkarkimit te pluhurave dhe gazeve te objektit, duke ndjekur nje cikël operacional per te percaktuar nje vlerë mesatare sa me reale per procese te tilla teknologjike.

Vlerat e matjeve te gazeve ne ppm, sipas burimit te ndotje

Emertimi	SO ₂	NO ₂	CO
Linja e bluarjes fraks. + 20 mm	0	0	0

Sheshi manipulimit te lendes pare	0	0	0
-----------------------------------	---	---	---

Perqendrimet e ndotesve te konvertuar ne mg/m³, ne kushte normale, presion 760 mm kollone zhive dhe ne grade C, jepen ne tabelen e meposhteme, te dhena te cilat jane percaktuar duke bere konvertimin paraprak te perqendrimit te ndotesve nga ppm ne mg/m³ ne kushtet konkrete te matjes, pastaj ate te kushteve normale, sig kerkohet edhe nga vendimi i qeverise te siperpermendur, per te bere krahasimin e tyre me normat ligjore.

Perqendrimet e ndotesve ne mg/m³, ne kushte normale, sipas burimeve te ndotjes e lendes se pare.

Objekti matjes	Temperatura mjedis grade C	Temperatura oxhakut gradeC	Presioni atmosferik mmKhg	Lende engurte	SO2	NO2	CO
Ne periferite sheshit manipulimit tek thyeresi	26	Nuk ka oxhak	754	85	0	0	0

Ne linjen e bluarjes tek mulliri	26		754	10	gjurme	0	gjurme
Norma				50	250	250	100

Linja e inerteve zbaton nje teknologji te njome, (dushimi i inerteve gjate procesit te larjes)

10-KONKLUZIONE DHE E REKOMANDIME

Kjo shoqeri ka intensifikuar punen per permiresimin e nivelit teknologjik, per rritjen e prodhimit, cilesite dhe koston, njekohesisht vemendje i eshte kushtuar investimeve per permiresimin e treguesve mjedisore.

Njekohesisht realizon nje produkt cilesor per industrine e ndertimit, si dhe indirekt ndikon ne problemet mjedisore gjate punes ne ndertim sepse eshte material me qendrueshmeri te larte mekanike e per rrjedhoje me pak mbetje gjate perdorimit.

Ne pergjithsi linja eshte ne prani uji e ka pak perhapje pluhuri, por vemendje duhet ne linjen e bluarjes se fraksionit + 20 mm tek mulliri e renia e materialit ne toke nga transportieri ne kohe te thate. Per nje veprimtari me te sigurte ne ruajtjen e mjedisit ne rekomandojme se:

Vemendje duhet perqendruar ne manipulimin e lendes pare, sidoemos ne periudhe kohe te thate e te ngrohte, duke perdor edhe sperkatje me uje rast pas rasti per evitim te pluhurit, kryesisht per sheshin e manipulimit te lendes pare e produktit, madje edhe ne nje pjese te segmentit lidhes te rruges me objektin.

Nje mase ndihmese mund te jete edhe orjentimi per shkarkimin e gazeve te mjeteve te renda nga poshte ne drejtim vertikal, pasi ul perhapjen e pluhurit ne kohe te thate prej presionit te gazeve te shkarkimit nga keto mjete neper sheshin e lendes pare e produktit. Kjo zbut edhe perhapjen e pluhurit ne rruget e pasfaltuara kur levizin keto mjete. Te aplikojme sperkatje me uje tek linja e thyerjes, per te evituar perhapjen e pluhurit ne mjedisin e punes e rreth objektit, si dhe te izolohe hapsirat midis kokes se transportierit e hyrjes se materialit ne gryken e mullirit.

Te behet me rigorozitet mbulimi me mushama I mjeteve qe transportojne inerte e sidomos produktin e gatshem, per te evituar jo vetem derdhjet por edhe pluhurin e krijuar nga era gjate levizjes se mjeteve, nga objekti ne destinacion.

Te izolohe hapsirat midis kokes se transportierit e grykes se hyrjes se materialit ne mulli, si per te evituar goditjet nga guret ashtu edhe perhapjen e pluhurit ne mjedisin e punes e perreth zones.

Per te ruajtur shendetin e operatoreve te linjes se bluarjes e sites, kerkohet perdorim te mjeteve mbrojtese, (tip kufie), krahas kontrollit periodik shendetesor te punonjesve. Normat ligjore per mjediset e punes jane krahasuar me ate te dispozitave ligjore te M. Shendetesise te miratuara ne vitin 1974.

- Perfundimisht theksojme se te dhenat e ketij monitorimi ballafaquar me normat ligjore te shkarkimit ne mjedis dhe ate ne mjediset e punes, tregojne per nje vleresim gjithenje ne rritje ne drejtim te ruajtjes se shendetit dhe mjedisit nga kjo shoqeri .

***TE DHENA PERGJITHESUESE PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS**

Bazuar ne Ligjin "Per mbrojtjen e mjedisit" te ndryshuar dhe ne permbajtjen e terminologjise se perdorur ne ligj konstatohet:

Objekti Linje perprodhimin dhe fraksionimin e Inerteve permban elementet e nje ekoprojekti duke marre ne konsiderate aspektet e ndikimit ne mjedis.

Gjate funksionimit te objektit si veprimtari per prodhimin e inerteve te fraksionuara nga guri gelqeror, nuk krijohen mbetje me natyre organike e qe nuk jane te biodegradueshme

Objekti i ndertuar nuk tjeterson siperfaqe te mjedisit me karakteristika te favoreshme per popullime gjallesash natyrore apo te kultivuara. Si objekt ka shkaktuar nje fragmentim te siperfaqes tokesore jo bujqesore por pa demtim te faunes dhe flores.

Ngritja e impiantit dhe vete veprimtaria e procesit teknologjik te linjes se fraksionimit te inerteve nuk shkaktojne demtime te mjedisit.

Po keshtu ,nuk shkaktojne shkarkime tej normave ne mjedis, nuk hedhin ne mjedis lende te rrezikshme e nuk shkaktohen ndotje nepermjet mbetjeve .

Objekti dhe veprimtaria e prodhimit te inerteve te fraksionuara nuk ndikojne ne perkeqesimin e parametrave optimale te treguesve mjedisor si ato fiziko kimik ashtu dhe ato biotik per zhvillimin normal te flores dhe faunes perreth.

Objekti nuk ndikon ne vleresimin strategjik mjedisor te zones tokesore kontinentale as edhe te asaje detare qe ndodhet ne afersi te obbjektit.

Te gjitha te dhenat per vleresimin e ndikimit ne mjedis si dhe zbatimi i te gjitha masave higjeno sanitare te parashkuara gjate funksionimit te impiantit si veprimtari prodhuese, nuk do te shkaktojne dukurine e nderhyrjes ne mjedis si veprimtari njerezore qe ndikon ne ekujlibrin natyror.

***PERFUNDIME**

1-Bazuar ne normat e lejueshme te percaktuara nga ligjet perkatese mbi ndikimet ne mjedis, subjekti qe zhvillon aktivitetin e prodhimit te inerteve te fraksionuara duhet te marre Lejen Mjedisore sepse nuk shkakton ndotje te mjedisit, pra nuk shkakton mbi normat e lejuara.

2 - Ndertimi dhe veprimtaria e objektit

Nuk demton ekosisteme

Nuk demton burimet natyrore

Nuk demton zhvillimet social-kulturore te zones, ku do te ngihet impianti i prodhimit te inerteve te

3 - Ndertimi dhe veprimtaria e impiantit

Nuk do ndikojne ne perkeqesimin e treguesve ekologjik te mjedisit ku do te ngihet impianti as edhe te mjediseve te tjera perrth tij.

Realizon punesim dhe ne perspektive do te hapi vende te reja pune

Mundeson plotesimin e tregut te brendshem me inerte per ndertime duke siguruar cilesine e nevojshme

11-SHTOJCAT

1.1 Shkarkimet ne ajer

Pyetje	po	jo	Nqse Po pershkruaj (tipin, sasina & burimin
A ka shkarkime ne ajer (nga oxhaqet)?		+	
A ka shkarkime ne ajer (nga burime te shperndarjes)?	+		Shkarkime ne ajer ka vetem ne momentin e furnizimit te kamioneve me inerte nga depozitat e inerteve simbas fraksioneve, por kjo jo ne te gjitha rastet mbasi ngarkimi shpesh behet ilagur
A ka erera te keqia ngashkarkimet?		+	

1.2 Shkarkime te ujrave te ndotur

Pyetje	po	jo	Nqse Po pershkruaj (tipin, sasina & burimin
A ka shkarkime te ujrave te ndotura?	+		Ujrat e ndotura do te quajm ujrat e lavatrices te cilat rjedhin ne kanal te vecant dhe shkarkojne ne lum, ndotje do te konsiderojme llumerat e inerteve qe shplahen por qe nuk ndikojne negativisht ne klim

A ka ujra te ndotura me natyre toksike?		+	
pyetje	po	jo	Nqse Po pershkruaj tipin, sasine & burimin)
A bene shkarkime ne rjetin e kanalizimeve?	+		Per mirmbajtjen e ambienteve ujrato do te rjedhin ne rjetin e kanalizimeve te linjes te ndertuara per kete qellim por keto nuk jane me mbetje te demeshme
A bene shkarkime ne siperfaqet ujore ?		+	

Jepni sasine e ujrave te ndotura (m ³ /dite)			
Jepni sasine e ujrave te ndotura (m ³ /dite)			

1.3 Zhurmat & vibracionet

Pyetje	p ^o	jo	Nqse Po pershkruaj tipin , sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma?	+		Zhurmat krijohen gjate kohes kur impjanti eshte ne pune, nga trasortieret, mulliri i thyerjes, (gjate funksionimit te elektromotorrave te paisjeve te linjes) po keto zhurma jane te pa ndieshme ne krahasim me zonen ku implementohet projekti
A gjenerohen vibracione?	+		Vibracione gjenerohen tek shosha dhe tek ushqyesi po keto jane te pa konsiderueshme se vibratorret jane te montuara mbi bazamente te forte te llogaritura per vibrime

1.4 Mbetjet e ngurta

pytje	p°	jo	Nqse Po pershkruaj tipin , sasine &burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta ?	+		Po pop la te cilat riciklohen dhe llumera apo baltera te cialt grumbullohen ne nje vaske dkantuese, materjali I dekantuar sitemohet nga subjekti ne ambjentin perreth dhe mbillen drure dekorativ
A gjenerohen mbetje te rezikeshme?		+	

Te asgjesuara ne teritorin eimpianti/instalimit?		+	
--	--	---	--

2. Shkarkimet e ujrave te ndotura 2.1. Pika e shkarkimit

jepni informacin se kur ka qene vendia ne pune dhe ose nderprerja e punes)

Nr, refer. I pikes se shkarkimit (numuri referues duhet te jete I njejt me numerin e shkruar ne harten e instalimit/impiantit)	Nuke kemi shkarkime me efekte negative
Burimni I shkarkimit	
Vendodhja	
Koordinatat ne sistemin shtetor koordinativ	
Emeri/emertimi i maresit, lumi, liqejnt etj)	

2.2. Informacion i detajuar per shkarkimet e lengeta

Sasia e shkarkuar			
Mesatare/dite Sasia maksimale/ore	m ³	Sasia maximale /dite	
Sasia maksimale/ore	m ³		

Jepni periudhen ose periudhat kur ka ndodhur shkarkimi duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprerja e punes)

Periudha e shkarkimit mesatar	Mini/ore	Ore/dite	Dite/vit
-------------------------------	----------	----------	----------

2.3. Karakteristikat e shkarkimeve te ujrave te ndotura

Parametri	Perpara trajtimit				Nga vendi i lirit/leshimit pas shkarkimit			
	Mesatarja Max . e vleres/ore e mg/l	Mesatarja Max . e vleres/dite remg/l	Kg/d	K g/vit	Vlra mesatare maks neore mg/l	Vlra mesatare maks mg /l	Kg/dite	K g/vit

Tabela 2- Perdorimi /sigurimi i nenergjise

	po	jo	Nqse Po pershkruaj (tipin, sasina & burimin)
A Perdoret energji?	+		Perdoret energji elektrike 245kw per trasportieret, vibratoret , mullinjte, shosha , ndricim dhe nevoja te tjera sherbimi burimi I furnizimit rjeti energjitike ekzistues.
A Prodhohet kjo energji ne teritorin e impiantit apo		+	Sigurohet nga kompania Cez-shperndarje nepermjet gabines

sigurohet nga burimet te tjera?		qe eshte prone e subjektit
---------------------------------	--	----------------------------

Tabela 3- Konsumi i energjise dhe uji

KONSUMI I ENERGIJE	
Burimi	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (Kwh/g,t/g, dhe te ngjashme)
Energji elektrike	500 kv/ h ne dite
KONSUMI I UJIT	Konsumi ditor dhe total baze,0,5m ³ /ton produkt
Burimi i furnizimit	
Puse personale	po

Punoi: Eksperti Mjedisor

Hysen Doci